



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**V E N D I M**

**Nr. 64, datë 31.03.2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 50, datë 15.03.2022, të z. Gj.K., ku pretendohet diskriminim, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Zyrës Arsimore Mirditë dhe Shkollës së Mesme të Bashkuar Perlat Mirditë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Pretendimet sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe akteve bashkëlidhur saj, rezulton se z. Gj.K. është diplomuar në vitin 1993, në degën Agronomi e Përgjithshme, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës. Në vijim, ai ka kryer studimet me kohë të pjesshme pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe në vitin 2007 është diplomuar për Biologji Kimi. Prej vitit 2002, ankuesi sqaron se ka dhënë mësim në lëndë të ndryshme, në shkollat 9-vjeçare të Mirditës, sipas formimit të tij profesional.

Referuar Vërtetimit nr. 86503/2, datë 19.05.2009, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Lezhë/KMCAP Mirditë, rezulton se z. Kola ka humbur aftësinë për punë në mënyrë të pjesshme dhe është përcaktuar si invalid i pjesshëm pune me diagnozë “PNU bil sëmundje renale kronike, stadi II e III, HTA sekondare”. Në këto kushte, që prej këtij viti ka punuar me ¾ e normës mësimore. Në vijim, me vendimin nr. 213, datë 01.03.2022, të KMCAP Mirditë, ankuesi është përcaktuar si invalid i plotë, duke qenë i paaftë për të kryer punë, prej datës 13.02.2022 e në vijim.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi sqaron se nga muaji tetor i vitit 2009 ka punuar mësues biologji-kimie pranë Shkollës 9-vjeçare Tarazh, Mirditë, e cila ndodhet 5 km nga qendra e tij e banimit. Kjo rrugë ka qenë e shtruar dhe e asfaltuar, ndaj ankuesi sqaron se ky pozicion pune ka qenë i përshtatshëm për të, pasi shkonte me makinë në punë dhe nuk kishte shumë tronditje. Z. Kola pretendon se ka dhënë mësim pranë këtij institucioni arsimor deri në datën 30.09.2011, pasi në këtë datë është njoftuar për takim nga drejtori i Zyrës Arsimore Mirditë, që në atë kohë ka qenë z. Gj. K., ku i është komunikuar verbalisht, që nuk mund të punojë më pranë kësaj shkolle, pa asnjë shkak të ligjshëm dhe në mënyrë arbitrare. Ankuesi pretendon se nxënësit e kësaj shkolle kanë qëndruar pa mësim në lëndët e tij, e në vijim u është dhënë mësim nga një mësues jashtë profilit, për më shumë se një muaj.

Z. Kola sqaron se nëpërmjet shkresës së datës 14.10.2011 është ankuar pranë ZA Mirditë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare. Në vijim, ankuesi shprehet se i është drejtuar me ankim edhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por sërish nuk i është kthyer përgjigje edhe nga ky institucion. Në muajin tetor 2011, z. Gj.K. sqaron se është transferuar, në mungesë të një akti me shkrim, në Shkollën 9-Vjeçare Perlat Epër Mirditë, shkollë kjo që ndodhet, rreth 20 km larg nga qendra e qytetit dhe është në varësi të Shkollës së Mesme të Bashkuar Perlat, Mirditë. Ndërkohë që, në pozicionin e tij të punës pranë Shkollës 9-vjeçare Tarazh, Mirditë, është emëruar një mësues tjetër që nuk ishte invalid, në atë kohë.

Gjendjen aktuale shëndetësore, ai e lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën që ka kryer pranë Shkollës 9-vjeçare Perlat Epër Mirditë, ku ka punuar prej vitit 2011. Ankuesi sqaron se rruga që duhet të kryente çdo ditë ishte shumë e vështirë, pasi ishte e pashtuar me asfalt dhe e shkatërruar. Ai pretendon se kryerja e përditëshme e kësaj rruge, si dhe ngarkesa mësimore kanë qenë shkak që gjendja e tij shëndetësore ka degraduar dhe ai është bërë plotësisht i paaftë për të kryer punë. Pranë kësaj shkolle, ai pretendon se ka mbajtur peshën kryesore të ngarkesës mësimore në lëndët biokimi, fizikë, matematikë dhe aftësim teknologjik.

Ankuesi sqaron se diskriminimi ndaj tij, nga subjektet përkatëse ka vazhduar edhe në vitet në vijim. Ai sqaron se në muajin shtator 2019, znj. D.Ll., drejtoreshë e Shkollës së Mesme të Bashkuar Perlat Mirditë, prej së cilës shkolla, ku punonte ankuesi kishte varësi dhe Zyra Arsimore Mirditë, kanë kryer vlerësimin e mësuesve të profilit kimi-biologji pranë Shkollës Perlat Epër Mirditë. Për kryerjen e këtij vlerësimi është ngritur një komision i posaçëm, i cili ka vlerësuar mësuesit në bazë të dokumentacionit të tyre. Ankuesi pretendon se në vijim, i është komunikuar nga drejtoresha e Shkollës së Mesme të Bashkuar Perlat dhe nga komisioni i vlerësimit, se është renditur i dyti në vlerësim dhe se do të jepte mësim pranë Shkollës Perlat Qendër, duke i dhënë edhe orët mësimore përkatëse. Në vijim, z. Kola pretendon se 3-4 ditë pas komunikimit, transferimi i tij në këtë shkollë është anuluar. Ankuesi është ankuar nëpërmjet shkresës së datës 13.09.2019 tek Zyra Arsimore Mirditë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare.

Z. Gj.K. thekson faktin se si pasojë e këtyre padrejtësive që i janë bërë që prej largimit të tij nga Shkolla 9-vjeçare Tarazh, në datën 05.11.2021 gjendja e tij shëndetësore është rënduar dhe ka kaluar në hemodializë dhe aktualisht është invalid i grupit të parë.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit në mënyrë të përsëritur, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e subjekteve të sipërcituara.

## **II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri**

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dha akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion. Për këtë arsye, KMD iu drejtua me e-mail ankuesit në datën 16.03.2022, ku iu kërkua informacioni vijues:

- 1. “Informacion mbi qëllimin e kryerjes së vlerësimit të dosjeve personale të mësuesve në profilin biokimi, në muajin shtator të vitit 2019, nga Drejtoria e Shkollës së Mesme Perlat Mirditë dhe Zyra Arsimore Mirditë.*
- 2. Të depozitohet në cilësi prove çdo njoftim apo shkresë e dërguar nga strukturat vlerësuese, të institucioneve të sipërcituara, në adresën tuaj, ku vërtetohet që ju keni qenë pjesë e këtij procesi vlerësimi, qëllimi i kryerjes se tij, si dhe të evidentohet renditja e mësuesve që i janë nënshtruar vlerësimit;*
- 3. Në formularin e ankesës suaj, është shënuar data 05.11.2021, si moment i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, ndërkohë që situata që ju pretendoni si diskriminuese ka ndodhur në muajin shtator 2019. Lutem të jepen shpjegime lidhur me datën e shënuar si moment të marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, si dhe ky moment të provohet me fakte dhe prova konkrete, që lidhen me subjektet përkatëse që janë cilësuar diskriminuese në ankese. Nëse ky moment, mban datë tjetër, të ndryshme nga ajo e shënuar në formular, lutemi të shënohet data e saktë;*
- 4. Referuar vërtetimit nr. 86503/2, datë 01.03.2022, të lëshuar nga KMCAP Mirditë rezulton se me vendimin nr. 213, datë 01.03.2022, e KMCAP-së, ju jeni përcaktuar si i paaftë për të kryer çdo lloj pune. Në këtë kontekst, KMD kërkon informacion mbi faktin nëse prej muajit mars 2022 e në vijim, ju vazhdoni ende të punoni pranë Shkollës Perlat Epër Mirditë apo pranë ndonjë shkolle tjetër të qytetit të Mirditës;*
- 5. Të dërgohet me e-mail kopje e librezes suaj të punës, si dhe të kontratës suaj të punës;”*

- Në përgjigje të e-mailit të dërguar nga Komisioneri, ankuesi dërgoi e-mailin e datës 23.03.2022, ku citohet:

*“Në përgjigje të kërkesës për informacion më të detajuar, në lidhje me ankesën ju informojmë si më poshtë:*

- 1. Vlerësimi i dosjeve të mësuesve të profilit biokimi është bërë në Shtator të vitit 2019 nga Drejtoresha e shkollës dhe komisioni i ngritur për këtë qëllim, pasi kemi qenë 3 mësues të profilit biokimi dhe numri i orëve mësimore ka qenë më i vogël se ngarkesa mësimore. Na janë kërkuar dokumentat dhe është bërë vlerësimi në bazë të dokumentave.*
- 2. Në pikën 2 thuhet që të sillen provat: Çdo komunikim ka qenë verbal dhe jo shkresor. E vetmja provë është ankesa ime drejtuar Drejtorisë arsimore për sqarim dhe vlerësim, për të cilën nuk mora asnjëherë përgjigje qoftë dhe formale. Komunikimi ka qenë verbal në prezencë të gjithë mësuesve në Këshillin Pedagogjik, ku më janë caktuar dhe orët mësimore. Sipas vlerësimit të komunikuar, renditja ka qenë: 1. F. Ll. 2. Gjergj Kola. 3. Gj. M.*
- 3. Në formularin e ankesës shënohet data 05.11.2021 si datë e marrjes dijeni për diskriminim, pasi në rëndim të gjendjes shëndetësore dhe mosmarrjes së përgjigjes zyrtare nga institucionet, ngarkesës së madhe në shkollë, siç dhe kam sqaruar si dhe konsultës me avokat jam bindur dhe kam kuptuar që jam diskriminuar dhe nuk jam trajtuar nga institucionet ashtu siç e kam merituar nga ligji në varësi të statusit si invalid pune.*
- 4. Në pikën 4 kërkohen dokumentat e invalidit. Nga data 19.05.2009 deri më 13.02.2022 kam qenë invalid pune i pjesshëm me  $\frac{3}{4}$  e normës mësimore. Me datën 13.02.2022 kam dalë invalid pune i përheshëm i plotë. Nga data 16.11.2021 deri me 13.02.2022 kam qenë me raporte të paaftësisë në punë nga KML.*
- 5. Nga data 15 nëntor nuk punoj më si mësues në atë shkollë as në ndonjë shkollë tjetër. Jemi në procedurë transplantit për veshkën. Bashkëngjitur po ju dërgoj dhe librezën e punës. Informacionet e tjera të kërkohen nga institucionet.”*

#### **Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:**

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

*vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), të LMD, i ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 33, pika 4, gërmat dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se ankesa nuk pranohet kur: “.... (dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dëgjimit për sjelljen diskriminuese.” Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Për sa më sipër, mbështetur në KMD ka konstatuar dhe vlerësuar se pretendimi për diskriminim i ankuesit ndahet në dy momente.

**Momenti i parë** lidhet me transferimin e ankuesit, në datën **01.10.2011**<sup>3</sup>, nga Shkolla 9-vjeçare Tarazh, e cila ishte 5 km nga vendbanimi i tij, në Shkollën Perlat Epër Mirditë, që ishte 20 km larg këtij vendbanimi. Lidhur me këtë moment, Komisioneri gjykon se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur në datën **01.10.2011**, e cila lidhet me transferimin e ankuesit. Shkresa

<sup>3</sup> Referuar librezës së punës së ankuesit Gj.K.;

ankesë e z. Kola drejtuar Zyrës Arsimore Mirditë mban datën **14.10.2011**. Në këtë kontekst, KMD gjykon se ankuesi supozohet të ketë marrë dijëni mbi këtë diskriminim përgjatë të njëjtit muaj, pasi ankesës së tij, nuk i është kthyer përgjigje nga ana e Zyrës Arsimore Mirditë. Ndërkohë që, vihet në dukje fakti se momenti i depozitimit të ankesës së z. Kola pranë KMD-së daton në **15.03.2022**. Në këto kushte, mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 4, gërma dh), të LMD të ndryshuar, Komisioneri gjykon se momenti, i ndodhjes dhe marrjes dijëni mbi diskriminimin e pretenduar, datojnë në tejkalim të dukshëm të afateve ligjore, të përcaktuara nga kjo dispozitë.

**Momenti i dytë**, konsiston në mostransferimin e tij në Shkollën 9-vjeçare Perlat Qendër, pas kryerjes së vlerësimit të mësuesve të lëndëve biologji-kimi, të Shkollës Perlat Epër Mirditë. Sipas ankuesit, procesi i vlerësimit ka ndodhur në muajin **shtator 2019**, edhe pse nuk ka depozituar asnjë fakt dhe provë të drejtpërdrejtë për të vërtetuar sa më sipër. Referuar formularit të ankesës, rezulton se ankuesi ka përcaktuar si kohë, kur ka ndodhur diskriminimi datën **10.09.2019**. Ndërkohë që si kohë të marrjes dijëni mbi diskriminimin e pretenduar ka vendosur datën **05.11.2021**. Për sa më sipër, Komisioneri çmon se në asnjë moment, data e marrjes dijëni për diskriminimin e pretenduar nuk është e vërtetuar me prova dhe fakte konkrete. Në këtë kontekst, KMD gjykon se ankuesi ka marrë dijëni mbi diskriminimin e pretenduar, në datën **16.09.2019**, moment kur shkresa e tij “Ankim” nr. 392 prot., datë 16.09.2019, për mostransferimin e tij pranë Shkollës Perlat Qendër, është regjistruar pranë Zyrës Arsimore Mirditë dhe kësaj shkrese nuk i është kthyer përgjigje.

Në vijim, rezulton se ai nuk ka kërkuar zyrtarisht transferimin e tij, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore apo nuk ka patur korrespondencë tjetër zyrtare me institucionet kundër së cilave drejtohet ankesa. Momenti i depozitimit të ankesës së z. Kola pranë KMD-se daton në **15.03.2022**. Duke gjykuar mbi të dhënat e sipërcituara, Komisioneri çmon se momenti, i marrjes dijëni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 50, datë 15.03.2022, së z. Gj.K. pranë KMD-së.

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr. 50, datë 15.03.2022, e z. Gj.K., pasi është jashtë afateve ligjore për t’u shqyrtuar nga ky institucion, por rekomandon që ankuesi të depozitojë kërkesëpadi me objekt konstatim diskriminimi pranë gjykatës kompetente<sup>4</sup>, për momentin e dytë të diskriminimit të pretenduar, pasi është ende brenda afateve ligjore, që çështja e tij të shqyrtohet gjyqësisht. Në çështje të tilla, Komisioneri thirret nga gjykata në cilësinë e palës së tretë, për të dhënë mendim mbi

---

<sup>4</sup> Referuar nenit 36/1, të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet: “1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje.”

objektin e shqyrtimit gjyqësor.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 50, datë 15.03.2022, e z. Gj.K., pasi është depozituar jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Punoi: E.Shyti  
Rishikoi: R. Babaj  
Miratoi: V. Bushati  
Dt. 29.03.2022